

FJALA E DEPUTETIT EDUARD NDRECA

E ENJTE 21 KORRIK 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë dhe fort të nderuar qytetarë,

Në fakt, e nderuara Avokate e Popullit ma prishi pak rendin e fjalës. Prisja një raportim të Avokates së Popullit, minimalisht një raportim siç ka bërë ditën kur ka qenë në Komisionin e Ligjeve, i cili do të nxirrte në pah punën që ka bërë institucioni i Avokatit të Popullit, që fatkeqësisht, avokatja nuk e tha, po do të detyrohem unë ta përmend, sepse do të respektoj institucionin, i cili nuk është institucion i ri; atje janë disa njerëz që punojnë dhe japin kontributin e tyre në të mirë të institucionit, duke bërë detyrën për të cilën janë ngarkuar.

Megjithatë, unë e kuptoj edhe klimën e nxehtë në të cilën ndodhemi, sepse ka filluar gara për avokaturën e popullit dhe duke qenë se zakoni ka qenë që propozimi të vijë nga opozita përpjekja për ta kthyer raportimin në një fjalim politik, me shpresën që të merret vota e opozitës, besoj se është qasja dhe shërbimi më i gabuar që mund t'i bëhet atij institucioni. Gjithsesi, në nderim të gjithë këtij institucioni, unë do të mbaj fjalën, siç e kisha parashikuar, duke vlerësuar edhe disa arritje që ka bërë ky institucion. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e vlerëson shumë rolin e Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe po ashtu vlerëson angazhimin e Avokatit të Popullit për të kryer funksionin e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, Kuvendi dallon disa arritje të institucionit të Avokatit të Popullit, për të cilat nuk u fol këtu: inspektimin, kushtet në të cilat trajtohen shtetasit në përgjithësi dhe të miturit në veçanti në institucionet e privimit të lirisë; inspektimin e institucioneve të shëndetit mendor dhe adresimin e rekomandimeve; angazhimin e Avokatit të Popullit për monitorimin e veprimtarisë së këshillit të emërimeve në drejtësi; bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të rrjetit global të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut e kështu me radhë; angazhimin në realizimin e raporteve për standardin e minimumit jetik në Shqipëri, zhvillimin e

aktiviteteve për përmirësimin dhe konsolidimin e njohurive të nxënësve për edukimin ligjor për të drejtat themelore të njeriut, veçanërisht fëmijëve; përfshirjen e Avokatit të Popullit në fazën e konsultimit të jashtëm për projektaktet e propozuara nga ministritë e linjës, si dhe përfshirjen në procesin legjislativ për dhënie mendimi apo për projektligje të ndryshme; angazhimin për raportin në mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, ku një ndihmesë e madhe e jashtëzakonshme do të jetë edhe projektligji që vjen sot në Kuvend dhe roli i Avokatit të Popullit në monitorimin e zgjedhjeve të 25 prillit dhe adresimin e të gjitha kërkesave të depozituara në këtë institucion.

Gjithashtu, draftrezoluta i lë Avokatit të Popullit një sërë rekomandimesh. Unë do t'i përmend rekomandimet por kam edhe diçka shtesë në fund të tyre për përsëritjen e vazhdueshme vit pas viti të tyre jo vetëm në këtë institucion, por edhe në shumë institucione që ne kemi dëgjuar në raportimin e tyre. Së pari, Kuvendi i kërkon Avokatit të Popullit të intensifikojë reagimin institucional për rekomandimet që nuk zbatohen ose në rast mosbashkëpunimi nga autoritetet publike me qëllim rritjen e besimit të publikut ndaj këtij institucioni; të informojë Kuvendin për institucionet që nuk kthejnë përgjigje për rekomandimet e adresuara si dhe të përfshijë në raportin vjetor dhe periodik institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje; të intensifikojë sesionet informuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve për të drejtat themelore të njeriut; të vijojë inspektimet dhe monitorimet e seksionit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rrisë numrin e rekomandimeve nga ky seksion, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; të rrisë aktivitetin ndërgjegjësues dhe informues në zyrat rajonale, me qëllim promovimin dhe nxitjen e respektimit të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve dhe promovimit të mekanizmave mbrojtës së tyre; të angazhohet në përgatitjen e një plani masash për informimin dhe promovimin e mekanizmave mbrojtjes së të drejtave dhe lirive me fokus të veçantë shtetasit vulnerabël dhe ata të marginalizuar të shoqërisë; të vijojë bashkëpunimin me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi përmes projekteve konkrete për të koordinuar dhe bashkëpunuar përpjekjet me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen dhe parandalimin e shkeljes. Siç e thashë edhe më sipër, dua të ndalem te rekomandimet.

Ne i përmendim këtu arritjet e institucioneve që raportojnë në komisionet parlamentare, por me gjithë këto arritje, Avokati i Popullit dhe çdo institucion tjetër, sidomos institucionet e pavarura, tek të cilat përsëriten të njëjtat rekomandime vit pas viti, u duhet një reflektim me patjetër. Këtë nuk e kam vetëm për Avokatin e Popullit, por për shumë institucione që kanë raportuar në komision, aq më tepër kur për këto mosrealizime ka justifikime të pavend. Fundja, rekomandimet janë vetëm një pjesë e detyrimeve ligjore që kanë institucionet dhe asnjë justifikim nuk ka vend. Uroj të vijë dita kur rekomandimet në këto draftrezoluta të pakësohen, çka do të nënkuptonte performancë shumë më të mirë të këtyre institucioneve dhe shuarjen e debateve boshe në komisione rreth performancës së tyre.

Kuvendi e ka mbyllur një pjesë të procesit të zgjedhjes së Avokatit të Popullit, pasi mandati ekzistues ka mbaruar. Kuvendi i Shqipërisë në këtë proces ka ecur deri këtu me seriozitetin më të madh të mundshëm, qoftë në fazën e plotësimit dhe dorëzimit të dokumentacioneve nga kandidatët deri te dëgjesa e 19 kandidatëve, pasi 1 prej tyre është tërhequr. Komisioni ka miratuar 19 kandidatët, për t'ua përcjellë grupeve dhe marrë propozimet prej tyre. E përmenda dëgjesën e kandidatëve, sepse nuk nguroj të them që ka qenë një ndër dëgjesat më cilësore, ku pjesa dërrmuese e kandidatëve ishin persona me integritet të lartë profesional. Mes kësaj pjese dërrmuese, besoj se kushdo mund të luajë rolin e Avokatit të Popullit në mënyrën më të mirë të mundshme, ndaj ju bëj thirrje të dyja grupeve që për anësi politike të mos bien në gabimin e nxjerrjes jashtë shinave të këtij institucioni, duke zgjedhur mes asaj pakice brenda këtyre kandidatëve, që nuk mund të quhen ndryshe përveçse kandidatë politikë.

Ne duhet të votojmë figurën që meriton ky institucion, që meriton delikatesa e madhe e çështjeve me të cilat merret ky institucion. Së fundi, si deputet i ri, meqë është edhe seanca e fundit, dua të ndaj me ju të gjithë përvojën time 1-vjeçare këtu. Patjetër, ky vit ka qenë i dendur, mjaft intensiv. Jam përpjekur në komisione dhe këtu, që përmes fjalëve, diskutimeve dhe debateve me ata me më shumë përvojë brenda këtyre muajve, të marr më të mirën e mundshme. Patjetër, kam mësuar shumë, por përtej kësaj, shumë shqetësuese ka qenë gjuha denigruese ndaj njëri-tjetrit, brenda së cilës përzihej i gjithë mllefi politik dhe personal i 30 vjetëve politikë. Gjithçka duhet të ketë një fund.

Besoj se sot më shumë se kurrë ne duhet ta braktisim këtë lloj modeli, sepse Europa na ka dhënë një shans të madh, ka hapur një kapitull të ri marrëdhëniesh me ne dhe ne duhet të hapim patjetër një kapitull të ri marrëdhëniesh me njëritjetrin. Kjo na vë përpara përgjegjësisë të çlirohemi, pikë së pari, nga kjo gjuhë, dhe secili, duke lëshuar nga pak prej vetes, të përpiqemi seriozisht të mos humbim asnjë minutë kohë, për ta bërë atdheun tonë pjesë të Bashkimit European. Kushdo që kërkon ta pengojë këtë me fjalë apo veprime dhe që kërkon të kthehet pas te politika e vjetër, duhet zbritur me çdo kusht nga treni drejt Bashkimit European i shqiptarëve të ndershëm dhe të zakonshëm të këtij vendi, të cilët boll kanë duruar. Faleminderit!